



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 971/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Sokol Thaçi nga Prishtina, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) për shkak të emrit të personit në listat e votuesve, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 02.12.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**HIDHET** si e palejuar ankesa e Sokol Thaçi nga Prishtina.

**Arsyetim**

Me datën 01.12.2013 Sokol Thaçi, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se te lista e regjistrimit civil e ka gjetur emrin e gjyshes së tij Hamide Thaçi e lindur me 27.07.1929 me numër 1010207793 e cila ka ndërruar jetë në vitin 2002.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e palejuar**

PZAP-i, vendosi ndaj vendimeve të KQZ-së sipas nenit 122 të LZP-së, prandaj edhe konstatoi se ankesa është e palejuar sepse nuk është në juridiksionin e PZAP-it që të ndërmerr masa përmirësuese ndaj listës së votuesve në rastet kur gjendet një emër i ndonjë personi i cili ka ndërruar jetë, ngase një çështje e tillë nuk parashihet me asnjë dispozitë ligjore të LZP-së, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 971/2013 më datën 02.12.2013.

Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha



***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*